



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



KONTRATË

Numri i kontratës ¹: 626-21-2846-1-3-6/C92

Komuna e Mamushës, të cilën e përfaqëson Gazmend Gashi në cilësinë e Udhëheqësit të sektorit të Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

Dhe

Operatori Ekonomik AWA SH.P.K., me numer të biznesit: 811345976 Selia në Prishtinë Rruga "Ilaz Kodra" dardani, , të cilën e përfaqëson z. Arjanit Rexhepi në cilësinë e drejtorit (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara më poshtë:

"Furnizimi materiale shpenzuese për zyre të cilat nuk janë të përfshira në kontratat e AQP-s" me numër identifikues të prokurimit: 626-21-2846-1-3-6 dhe numër të brendshëm: 626-21-013-1-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate ka të bëjë me furnizimin me material të ndryshëm shpenzues për zyre për nevojat e shkollave në Mamushë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

SPECIFIKIMET E DETYRUESHME TEKNIKE MINIMALE			
Artikulli	Specifikacioni	Njësia	Sasia
1.	Markera White Board 1664M NOKI- ose ekuivalent me ngjyra Zi-kaltër dhe Kuq	Copë	3,000.00
2.	Shpuz për tabel T-29	Copë	35.00
3.	Hamera DC204,DC205,DC207	Copë	100.00
4.	Shlyerës -Korrektues i ngurtë i tekstit të printuar	Copë	10.00
5.	Topat e futbollit të jen kualitativ të qepur me dy shtresa,shtresa e jashtme 1.5mm nga materiali lëkurës kurse shtresa e mbrendshme nga materiali late. Madhësia e topit të futbollit nr 5 nga malten,adidas,nike ose ekuivalent.	Copë	5.00
6.	Topat e volejbollit të jen kualitativ me 18 panele nga lëkura sintetike kurse shtresa e brendshme te jete nga goma "butyl" madhësia nr 5 nga adidas,molten nike ose ekuivalent.	Copë	5.00
7.	Topat e basketbollit të jen kualitativ me dy shtresa nga marka spallding, adidas, molten ose ekuivalent.	Copë	5.00
8.	Harta e Republikës së Kosovës Dyanësore, Dimensionet 100/140 cm (Përshkrimi në Hartë duhet të jetë në Gjuhën Turke)	Copë	2.00
9.	Harta e Shteteve të Ballkanit Dyanësore, (duhet të jetë në Gjuhën Turke) Dimensionet 100/140 cm (Përshkrimi në Hartë duhet të jetë në Gjuhën Turke)	Copë	2.00

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë **15** ditë nga koha e porosisë nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë: **Materialet do të dorëzohen në objektet e shkollave në Mamushë.**

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP³ (Detyra e Dërguar e Paguar)..

Neni 3 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **848,10 €; Tetëqind e dyzet e tetë Euro e dhjetë Eurocent.**

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 **Operatori Ekonomik duhet të ofroj materialet e kualitetit të lartë të përshkruar sipas specifikacionit teknik të cekur në Dosjen e Tenderit. Në rast të konstatimit të ndonjë të metë të mallit nga njësia e pranimit Operatori Ekonomik është i detyruar që mallin ta zëvendësoj me mall pa të metë.**

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes,

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

³ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare



fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamentin për Çështje Ekonomike në pajtim me ligjin e Kosovës.



Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Arjanit Rexhepi	Emri:	Gazmend Gashi
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Udhëheqës i sektorit të Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	30.06.2021	Data:	30.06.2021
Vula:		Vula:	



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUŠA



Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Titulli i Tenderit: “Furnizimi materiale shpenzuese për zyre të cilat nuk janë të përfshira në kontratat e AQP-s”

Nr. i Prokurimit ¹	626-21-2846-1-3-6
Nr i brendshëm	626-21-013-1-3-6

“Furnizimi materiale shpenzuese për zyre të cilat nuk janë të përfshira në kontratat e AQP-s”					
Artikulli	Specifikacioni	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi me TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €
1.	Markera White Board 1664M NOKI- ose ekuivalent me ngjyra Zi-kaltër dhe Kuq	Copë	3,000.00	0.17	510.00
2.	Shpuz për tabel T-29	Copë	35.00	0.28	9.80
3.	Hamera DC204,DC205,DC207	Copë	100.00	0.30	30.00
4.	Shlyerës -Korrektues i ngurtë i teksit të printuar	Copë	10.00	0.30	3.00
5.	Topat e futbollit të jen kualitativ të qepur me dy shtresa, shtresa e jashtme 1.5 mm nga materiali lëkurës kurse shtresa e mbrendshme nga materiali late. Madhësia	Copë	5.00	14.00	70.00

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

	e topit të futbollit nr 5 nga malten, adidas, nike ose ekuivalent.				
	Topat e volejbollit të jen kualitativ me 18 panele nga lëkura sintetike kurse shtresa e brendshme të jete nga goma "butyl" madhësia nr 5 nga adidas, molten nike ose ekuivalent.	Copë	5.00	13.50	67.50
7.	Topat e basketbollit të jen kualitativ me dy shtresa nga marka spalding, adidas, molten ose ekuivalent.	Copë	5.00	14.00	70.00
8.	Harta e Republikës së Kosovës Dyanësore, Dimensionet 100/140 cm (Përshkrimi në Hartë duhet të jetë në Gjuhën Turke)	Copë	2.00	21.95	43.90
9.	Harta e Shteteve të Ballkanit Dyanësore, het të jetë në Gjuhën Turke) Dimensionet 100/140 cm (Përshkrimi në Hartë duhet të jetë në Gjuhën Turke)	Copë	2.00	21.95	43.90
Totali i përgjithshëm duke aplikuar të gjitha taksat dhe tatimet					848.10

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	AWA SH.P.K.
ADRESA E PLOTE	RR. ILIAZ KODRA DARDANI PRISHTIEN
PËRFACËSUAR NGA:	
EMRI & MBIEMRI	ARJANIT REXHEPI
POZITA	DREJTOR
NËNSHKRIMI	
DATA	26.05.2021
VULLA	